

AKT THEMELIMI
i shoqërisë "MedWallet" Sh.p.k.

Sot, më datë 10 / 10 / 2024,

- **Z. Laert Kraja**, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës, më 21/05/1982, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. I20521152D, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Z. Endri Burrja**, shtetas Shqiptar, lindur në Shkoder, më 21/09/1989, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. I90921073P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**MedWallet**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Themelohet një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "**MedWallet**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: Rruga "Fadil Rada", Nr.pasurie 6/660/ND-N6, Zone kadastrale 8150 Ndertesë Nr.2, H.5, Ap.2, Tirane.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Te krijoje, zhvilloje, zbatoje dhe mirembajë programe kompjuterike, teknologji informacioni të prodhuar nga Shoqëria ose pale të treta dhe integrimin e sistemeve teknologjike dhe çdo veprimtari tjetër që gjeneron të ardhura dhe që nuk bie ndesh me ligjet Shqiptare në fuqi.
- Shoqëria ofron këshilla dhe shërbime konsulence për teknologjinë e informacionit dhe teknologjinë kompjuterike.
- Shoqëria ofron shitje me shumicë të produkteve/shërbimeve kompjuterike për zgjidhje për transaksione financiare, bankare dhe zgjidhje pagesash të çdo lloji; tregtim i pajisjeve të teknologjisë së informacionit, tregtim të pajisjeve të zyrës, tregtisë së pajisjeve dhe njesive elektronike dhe telekomunikacionit, dhenie me qira të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe aktivitete të tjera të shërbimit të teknologjisë së informacionit dhe kompjuterit, etj sipas statutit.



- Tregtim paisjeve Kompjuterike, Import-Eksport, Instalim, Konfigurim, Operim dhe Mirmbajtje te paisjeve IT, Telefonise, Telekomunikacionit, Sigurise se Informacionit audio/video.
- Mirmbajtje dhe Prodhim Webi.
- Tregtim me shumice dhe pakice te te gjithave paisjeve kompjuterike,, Printerave,Serverave, Software, etj.
- Realizimin, tregtimin, menaxhimin, dhënien në perdorim dhe mirëmbajtjen e sistemeve informatike dhe te programeve per perdorues elektronike;
- Organizimin e personelit, të pajisjeve te zyrave dhe te mjeteve te tjera materiale apo ndihmese me qellim vënien në dispozicion të profesionisteve apo shoqerive, zyrave të mobiluara dhe funksionale (sekretari, pajisje edhe të kompjuerizuara, organizim i mbledhjeve);
- Organizimin e kurseve te formimit dhe seminareve edhe online, në perputhje me/ legjislacionin në fuqi, prodhimin dhe tregtimin e publikimeve (perjashtuar gazetate), te moduleve dhe materialeve te ndryshme, lidhur me shërbimet e dhëna dhe, në pergjithesi, lidhur me menaxhimin e shoqerive;
- Analizën, prodhimin, fumizimin, tregtimin, instalirnin, riperdorimin dhe menaxhimin e programeve dhe sistemeve “software”, si bazë ashtu edhe aplikative të pergjithesuara dhe/ose per tregje te posacme, dhe projektimin e ndërtimeve te sistemeve informatikë dhe telematikë, per administrimin e personelit dhe menaxhimin e fondeve të pensionit dhe të fondeve per sigurimet dhe veprat e shërbirnet perkatese;
- Ideimin, realizimin, fumizimin dhe shitjen e cdo produkti/sherbimi/konsulence dhe asistencën perkatese edhe nëpërmjet “call-center” per subjekte dhe private lidhur me administrimin dhe menaxhimin e personelit, menaxhimin e fondeve të pensionit dhe fondeve të sigurimeve dhe veprave e shërbimeve perkatese;
- Realizimin, blerjen, shitjen dhe qiradhenien e “software”-ve, të aparateve elektronike dhe pajisjeve e aksesoreve dhe të licencave software, si edhe prodhimin, tregtimin, qiradhenien e produkteve hardware te veta apo te blera nga të tretë me shërbimin e asistences perkatese teknike;
- Asistencë teknike dhe mirëmbajtje te “software”;
- Perdorim i sistemeve telematike (p.sh. “internet”) per marrjen dhe transmetimin e te dhenave;
- Perdorim dhe menaxhim i përpunuesve të së dhënave, regjistruuesve dhe pajisjeve të tjera per përpunimin e te dhenave te veta dhe/ose per llogari te se treteve;
- Analizë, programim dhe ofrim shërbimesh përpunimi të pergjithesuara ne sektorët e punes, social dhe ekonomik, nepermjet kryerjes se çdo veprimtarie te nevojshme;
- Organizimi dhe kryeia e veprimtarive menaxhuese, vlerësim formimi dhe trajnim i personelit, si edhe organizim i shoqerise, dhe çdo veprimtari lidhur me to;
- Krijimi i softuerit (ecommerce, faqet e internetit, aplikacionet, etj.);
- Hosting dhe Server - Konsulencë IT;
- Krijimin, zhvillimin dhe implementimin e programeve software, telekomunikacioni, teknologji informative te prodhuar prej saj ose personave të trete;
- Realizimin e zhvillimit, shitjes dhe implementimin e tyre brenda dhe jashtë vendit. Import - eksport të paisjeve hardware elektronike, lëndës së pare, produkteve gjysem te gatshme të ndërtimeve dhe integritimeve te sistemeve teknologjike.
- Krijimi dhe zhvillimi i software, aplikacioneve ne fushen e mjekesise.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në para dhe në natyrë i ortakëve themelues në vlerën 10.000.000 Lek (*dhjete milion*) Lek dhe është i përbërë nga 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Laert Kraja**, zoteron 1 kuotë, me 51% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë kontribut në natyrë me vlerë 5.100.000 Lek (*pese milion e njeqind mije*) Lek dhe 5.100.000 Lek (*pese milion e njeqind mije*) Lek të kapitalit themeltar.
- **Z. Endri Burrja**, zoteron 1 kuotë, me 49% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë kontribut në para me vlerë 4.900.000 Lek (*kater milion e nenteqind mije*) Lek dhe 4.900.000 Lek (*kater milion e nenteqind mije*) Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë ose të zvogelohet, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me vendimmarrje unanime.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- **Z. Endri Burrja**, shtetas shqiptar, lindur me 21/09/1989, në Shkodër, Shqipëri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. personal I90921073P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, caktohet Administrator i shoqërisë.
- Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8


DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues i shoqërisë duke autorizuar *Administratorin Z. Endri Burrja*, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

LAERT KRAJA

Laert Kraja


ENDRI BURRJA

Endri Burrja
